

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group Sh.a - Dega Kosovë

**Pasqyrat Financiare të përgatitura në përputhje me Standardet
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe skedulet plotesuese
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Tabela e përmbajtjes

Raporti i audituesit të pavarur	i
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në mbetjen neto që i takon zyrës qendrore	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
1. Informacione të përgjithshme	5
2. Mjedisi i funksionimit të Degës	5
3. Bazat e kontabilitetit	6
4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara	6
5. Standardet e reja kontabël	7
6. Politika të rëndësishme kontabël	8
7. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit	15
8. Menaxhimi i rrezikut financiar	20
9. Vlerësimet dhe gjykimet në zbatimin e politikave kontabël	23
10. Vlera e drejtë	24
11. Aktive afatgjata materiale	25
12. Aktivet me të drejte perdorimi dhe detyrimet për qira	25
13. Aktivet afatgjata jomateriale	26
14. Aktive të risigurimit	27
15. Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	27
16. Depozita me afat me banka	28
17. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	28
18. Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	29
19. Aktive të tjera	29
20. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	30
21. Kapitali themeltar	30
22. Detyrime për kontratat e sigurimit	30
23. Rezerva e primit të pafitur	31
24. Depozita e risiguruesit	31
25. Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	31
26. Prime të shkruara bruto	32
27. Prime të ceduara tek risiguruesit	32
28. Shpenzimet e marrjes në sigurim	32
29. Shpenzimet administrative	33
30. Të ardhura nga komisionet e risigurimit	34
31. Të ardhura nga investimet dhe shpenzimet financiare	34
32. Tatimi mbi fitimin	34
33. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara	35
34. Palët e lidhura	35
35. Ngjarje pas dates së raportimit	36
Skedule plotesuse	37

Raporti i Auditorit të pavarur

Drejtuar aksionareve të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A.:

Raport për auditimin e pasqyrave financiare

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A. Dega në Kosovë ("Dega") më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të Degës përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në mbetjen neto që i takon zyrës qendrore për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë*.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Dega në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (kodi i BSNEK) dhe kërkesat e etikës të Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) të cilat janë të zbatueshme për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së dhe kërkesat e etikës së KKRF-së.

Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Ndërkohë, janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.

PricewaterhouseCoopers Kosovo SH.P.K.
Rr. Mujo Ulqinaku, Nr. 5, Ap. 10, Qyteza Pejton, 10 000, Prishtinë, Kosovë
T: +383 (0) 38 722 555, www.pwc.com/ks

Shërbimet joaudituese

Ne deklarojmë se, në dijeninë tonë më të mirë, shërbimet joaudituese të cilat ia kemi ofruar Degës janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës dhe nuk kemi ofruar shërbime joaudituese të cilat janë të ndaluara nga neni 5 "Ndalimi i ofrimit të shërbimeve joaudituese" i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019 "Për Pavarësinë e Auditorëve Ligjor dhe Firmave të Auditimit".

Përqasja jonë e auditimit

Përmbledhje

Materialiteti

- Materialiteti i përgjithshëm për pasqyrat financiare të Degës: 240 mijë Euro, që përfaqëson përafërsisht 2% të primeve të shkruara bruto.

Çështjet e rëndësishme të auditimit

- Çmuarjet kontabël në lidhje me detyrimet për kontratat e sigurimit për biznesin jo-jete.

Si pjesë të planifikimit të auditimit tonë, ne kemi përcaktuar materialitetin dhe kemi vlerësuar rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare. Në veçanti, ne kemi marrë në konsideratë gjykimet subjektive të kryera nga Drejtuesit; për shembull, në lidhje me çmuarjet e rëndësishme kontabël të cilat kanë përfshirë supozime dhe marrje në konsideratë të ngjarjeve të ardhshme të cilat vetvetiu përmbajnë pasiguri. Si në të gjitha auditimet tona, ne kemi adresuar gjithashtu rrezikun e anashkalimit të kontrolleve nga Drejtuesit, duke përfshirë ndër të tjera marrjen në konsideratë nëse ka pasur evidencë të anshmërisë e cila përbën rrezik të anomalisë materiale si rrjedhojë e mashtrimit.

Ne kemi përshtatur qëllimin e auditimit tonë në mënyrë që të kryejmë procedura të mjaftueshme për të na dhënë mundësinë të japim një opinion për pasqyrat financiare në tërësi, duke marrë në konsideratë strukturën e Degës, proceset dhe kontrollet e kontabilitetit, dhe industrinë në të cilën Dega operon.

Materialiteti

Qëllimi i auditimit tonë ndikohet nga zbatimi ynë i materialitetit. Një auditim është i planifikuar në mënyrë të tillë që ne të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Bazuar në gjykimin tonë profesional, ne kemi përcaktuar pragje të caktuara sasiore për materialitetin, duke përfshirë materialitetin e përgjithshëm të Degës për pasqyrat financiare në tërësi, siç tregohet në tabelën e mëposhtme. Këto, bashkë me faktorët cilësorë, na kanë ndihmuar të përcaktojmë qëllimin e auditimit si dhe natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave tona të auditimit dhe vlerësimin e efekteve të anomalive individualisht apo të marra së bashku në pasqyrat financiare në tërësi, kur ka të tilla.

Materialiteti i përgjithshëm	240 mijë Euro
Si e kemi përcaktuar	Përafërsisht 2% e primeve të shkruara bruto
Arsyetimi për përdorimin e nivelit referues të zbatuar të materialitetit	<p>Dega është e orientuar drejt fitimit. Megjithatë, marrë parasysh luhatjet në fitimet e Degës, është konsideruar që fitimi nuk përfaqëson në mënyrë të duhur madhësinë relative të veprimtarisë së Degës, gjë që e bën më pak të përshtatshëm si nivel referues për përcaktim të materialitetit. Për këto arsye, sipas nesh, fitimi para tatimit nuk është niveli referues i përshtatshëm për të përcaktuar materialitetin për pasqyrat financiare. Bazuar në sa më sipër, ne kemi përdorur një matës tjetër të lidhur me performancën, përkatësisht primet e shkruara bruto, si nivel referues për materialitetin tonë.</p> <p>Ne kemi zgjedhur nivelin 2% duke qenë se ne besojmë se ky nivel është brenda vargut të pranueshëm të pragjeve sasiore të materialitetit për nivelin e përcaktuar të referimit, duke marrë parasysh rrethanat përkatëse.</p>

Çështjet e rëndësishme të auditimit

Çështjet e rëndësishme të auditimit, janë ato çështje të cilat, në gjykimin tonë profesional, ishin shumë të rëndësishme në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë adresuar në kontekst të auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë, dhe ne nuk japim opinion të veçantë për këto çështje.

Çështja e rëndësishme e auditimit	Si e ka adresuar auditimi jonë çështjen e rëndësishme të auditimit
<p><i>Çmuarjet kontabël në lidhje me detyrimet për kontratat e sigurimit.</i></p> <p>Rezervat e dëmeve për biznesin jo-jetë kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rezerva për dëmet e raportuara por të pazgjdhura ("RBNS"); • Rezerva për dëmet e ndodhura por të paraportuara ("IBNR"); dhe • Rezerva për dëmet e ndodhura por jo mjaftueshëm të raportuara (IBNER). <p>Dega ka regjistruar RBNS, IBNR dhe IBNER siç paraqitet në Shënimin 22 të pasqyrave financiare -</p>	<p>Përjasja jonë e auditimit ishte si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ne vlerësuam dhe testuam efektivitetin e hartimit dhe funksionimit të kontrolleve të zgjedhura, si manuale ashtu edhe atyre të varura nga teknologjia e informacionit, në lidhje me ciklin e dëmeve që lidhen me rezervat. • Për një kampion të dosjeve të dëmeve, ne testuam se rezerva e dëmit rivlerësohet në fund të çdo muaji dhe përditësohet në mënyrë periodike me informacione të reja relevante. • Ne kemi zbatuar kritere specifike të rrezikut për popullatën e RBNS në 31 dhjetor 2020 në mënyrë që të identifikojmë ndonjë dëm të pazakontë.

Çështja e rëndësishme e auditimit

si detyrime për kontratat e sigurimit në shumën prej 10,172,190 Euro.

Vlerësimet e rezervave të dëmeve u konsideruan si një çështje kryesore e auditimit për shkak të peshës relativisht të lartë të rezervave të dëmeve në detyrimet totale të Degës, ndikimit të tyre të mundshëm në rezultatet e Degës dhe nivelit të gjykimit të përfshirë në vlerësimin e mjaftueshmërisë së këtyre rezervave.

Edhe pse të gjitha llojet e rezervave të specifikuar më lart vlerësohen për dëmet e ndodhura që Dega do të duhet të zgjidhë në të ardhmen, natyra e vlerësimeve dhe shkalla e kërkuar e gjykimit është e ndryshme për çdo rezervë.

RBNS vlerësohet dhe përditësohet çdo muaj bazuar në informacionin mbi dëmet e raportuara në Degë, në mënyrë që rezerva e akumuluar të jetë e mjaftueshme për të mbuluar zgjidhjen e atyre dëmeve bazuar në veçoritë e secilit dëm.

IBNR përcaktohet bazuar në vlerësimin e Degës për dëmet e pritshme për ngjarjet që kanë ndodhur por nuk janë raportuar ende. Vlerësimi përkatës kryhet në bazë të metodave aktuariale dhe të dhënave historike për një periudhë të tillë përfaqësuese që IBNR të jetë e mjaftueshme për të mbuluar dëmet e ndodhura që do të raportohen në periudhat financiare në vijim.

IBNER është njohur si rezervë në raport me shpenzimet e pritshme të dëmeve, të cilat tejkalojnë vlerësimin fillestar. Kjo rezerva krijohet për të adresuar zhvillimet e ardhshme të dëmeve në bazë të informacioneve të mëtejshme kur ato vendosen në dispozicion. Drejtuesit presin që këto llogaritje të mbulojnë dëmet që Dega mund të pësojë si rezultat i çështjeve gjyqësore.

Si e ka adresuar auditimi jonë çështjen e rëndësishme të auditimit

Kriteret u përcaktuan bazuar në njohuritë dhe kuptimin tonë të veprimtarisë së Degës dhe industrisë.

- Për një kampion të dosjeve të dëmeve të identifikuara pas zbatimit të secilit kriter të rrezikut, ne kërkuam dhe morëm një shpjegim në lidhje me vlerësimin e rezervës nga Drejtuesit e Degës. Kur ishte e nevojshme, ne i vërtetuam shpjegimet duke iu referuar dokumenteve mbështetëse përkatëse.
- Për IBNR dhe IBNER kemi vlerësuar metodologjinë e përdorur nga Dega dhe kemi vërtetuar të dhënat bazë të përdorura në modelet e Degës. Në lidhje me IBNR, specialistët tanë aktuarë zhvilluan një vlerësim të pavarur të pritshmërive për të vlerësuar nivelin e rezervave të pritura për linjat e rëndësishme të biznesit.
- Kryem analiza të mëtejshme për ato raste ku u gjetën dallime materiale midis pritjeve tona dhe vlerësimeve të Drejtuesve.
- Për të marrë në konsideratë anshmërinë e mundshme në vlerësimin e Drejtuesve, ne kemi vlerësuar përshtatshmërinë e rezervave të RBNS dhe IBNR të raportuara në fund të periudhës së raportimit paraprak, përkatësisht me 31 dhjetor 2019 kundrejt dëmeve të paguara dhe rezervës për dëme krijuar gjatë vitit 2020 ("analiza e shmangies") dhe ne i morëm në konsideratë rezultatet e kësaj analize në supozimin e përdorur për vlerësimin e RBNS dhe IBNR më 31 dhjetor 2020.

Informacionet e tjera

Drejtuesit janë përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përmbajnë skedulet plotësuese që përfshijnë "Aftësinë paguese" dhe "Tabelën për llogaritjen e kapitalit" (por që nuk i përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit).

Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjera dhe ne nuk do të shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Nëse, bazuar në punën që kemi kryer, arrijmë në përfundim se ekziston një anomali materiale në këto informacione të tjera, ne jemi të detyruar ta raportojmë atë fakt. Nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

Përgjegjësitë e drejtuesve dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat Drejtuesit i gjykojnë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtuesit e Degës janë përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Degës për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur Drejtuesit synojnë ta likuidojë Degën apo ajo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e Degës janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Degës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomali të mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Degës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtuesit.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Drejtuesit dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Degës për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditorit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Degës.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Degës, ndërmjet tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga auditori, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu deklarojmë përpara personave të ngarkuar me qeverisjen se ne kemi zbatuar kërkesat përkatëse të etikës në lidhje me pavarësinë, dhe komunikojmë me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që në mënyrë të arsyeshme mund të mendohet se ndikojnë pavarësinë tonë, dhe aty ku është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe rrjedhimisht janë çështjet kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditorit, përveç rasteve kur ligjet ose rregulloret e ndalojnë shpalosjen publike në lidhje me çështjen, ose kur, në rrethana jashtëzakonisht të rralla, ne përcaktojmë që një çështje nuk duhet të komunikohet në raportin tonë sepse pasojat e pafavorshme nga ky komunikim pritet që në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet e interesit publik nga ai komunikim.

Raportim në lidhje me kërkesa të tjera ligjore dhe rregullatore

Emërimi

Ne u emëruam për herë të parë si auditor të Degës më 18 korrik 2017. Emërimi ynë është rinovuar çdo vit me rezolutë të aksionarëve që përfaqëson një periudhë të emërimit të pandërprerë të angazhimit prej katër vitesh.

Auditor ligjor në angazhimin e auditimit që bëri të mundur këtë raport të auditorit të pavarur është Jonid Lamllari.

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Kosovo SH.P.K.

Auditori Ligjor

Jonid Lamllari



7 prill 2021

Prishtinë, Kosovë

Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group sh.a. - Dega Kosovë
Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive afatgjata materiale	11	392,663	405,527
Aktivet me të drejtë përdorimi	12	2,029,681	1,028,460
Aktive afatgjata jo-materiale	13	282,371	307,706
Aktive të risigurimit	14	5,450,289	4,614,791
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuara	15	6,528,388	4,297,031
Depozita me afat me banka	16	9,175,647	9,596,947
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	17	427,778	669,938
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	18	1,194,796	1,434,998
Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat e korporatave		14,626	-
Aktive të tjera	19	390,346	240,185
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	20	919,004	928,589
GJITHSEJ AKTIVET		26,805,589	23,524,172
DETYRIMET			
Detyrime për kontratat e sigurimit	22	10,172,190	9,146,959
Rezerva e primit të pafiturar	23	4,550,861	4,076,743
Depozita e risiguresit	24	2,883,086	2,450,968
Detyrimet për qira	12	2,075,036	1,046,168
Detyrimet për tatimin mbi të ardhurat e korporatave	32	-	14,808
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	25	1,126,538	1,176,603
GJITHSEJ DETYRIMET*		20,807,711	17,912,249
MBETJET NETO QË I TAKOJNË ZYRËS QENDRORE			
Kapitali themeltar	21	3,200,000	3,200,000
Rritja e akumuluar në mbetjet neto që i atribuohen zyrës qendrore	21	2,797,878	2,411,923
GJITHSEJ MBETJET NETO QË I TAKOJNË ZYRËS QENDRORE		5,997,878	5,611,923

*) duke mos i përfshirë mbetjet që i takojnë Zyrës Qendrore.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më datë 7 prill 2021 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:


 Z. Genond Mesareja
 Drejtor i përgjithshëm


 Znj. Gylsa Reka
 Drejtoreshë financiare



Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Prime të shkruara bruto	26	11,574,974	10,919,478
Ndryshimi bruto në rezervën për primet e paguara		(474,118)	(351,295)
Te ardhura nga primet i sigurimit		11,100,856	10,568,183
Prime të ceduara tek risiguresit	27	(5,614,617)	(4,754,118)
Ndryshimi në rezervën e risiguresit për primet e paguara të tjera nga MTPL dhe aksidentet		30,133	(156,246)
Ndryshimi në rezervën e risiguresit për primet e paguara nga MTPL dhe aksidentet		282,462	201,188
Të ardhura të primet të sigurimit të ceduara të risiguresit		(5,302,022)	(4,709,176)
Të ardhura neto nga primet e sigurimit		5,798,834	5,859,007
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	30	1,411,624	1,029,485
Të ardhura nga investimet dhe shpenzimet financiare	31	377,080	391,159
Të ardhura të tjera		9,814	14,533
Të ardhura neto		7,597,352	7,294,184
Dëme të paguara bruto		(4,570,772)	(6,768,677)
Dëme të paguara nga risiguresit		1,135,175	2,985,725
Ndryshimi bruto në rezervën e dëmeve		(1,025,231)	(686,772)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguresit		805,366	606,931
Dëmet neto të sigurimit		(3,655,462)	(3,862,793)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	28	(866,265)	(948,454)
Tatim mbi primin		-	(340,091)
Shpenzime administrative	29	(2,236,139)	(2,134,779)
Shpenzime gjithsej		(6,757,866)	(7,286,117)
Shpenzime financiare	31	(105,024)	(86,970)
Humbja net nga kursi i këmbimit		(4,619)	9,988
Fitimi/(humbja) para tatimit, shperndarjeve tek zyra qendrore dhe rimatjes të mbetjese neto qe i takon zyres qendrore		729,843	(68,915)
Tatimi mbi fitimin	32	(103,888)	(14,808)
Fitimi/(humbja) pas tatimit dhe para shperndarjeve tek zyra qendrore dhe rimatjes të mbetjese neto qe i takon zyres qendrore		625,955	(83,723)
Shpërndarja tek Zyra Qendrore		(240,000)	-
Rritja/(ulja) në mbetjen neto qe i takon zyres qendrore		385,955	(83,723)

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Pasqyra e ndryshimeve në mbetjen neto që i takon zyrës qendrore

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Mbetja neto që i takon kapitalit themeltar	Rritja e akumuluar në mbetjen neto që i takon zyrës qendrore	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2019	3,200,000	2,495,646	5,695,646
Humbja pas tatimit dhe para shpërndarjeve tek zyra qendrore, dhe rimatja e mbetjes neto që i takon zyrës qendrore	-	(83,723)	(83,723)
Ulja e mbetjes neto që i takon zyrës qendrore	-	(83,723)	(83,723)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	3,200,000	2,411,923	5,611,923
Fitimi pas tatimit dhe para shpërndarjeve tek zyra qendrore dhe rimatja e mbetjes neto që i takon zyrës qendrore	-	625,955	625,955
Shpërndarja tek zyra qendrore	-	(240,000)	(240,000)
Rritja e mbetjes neto që i takon zyrës qendrore	-	385,955	385,955
Gjendja më 31 dhjetor 2020	3,200,000	2,797,878	5,997,878

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Pasqyra e flukseve monetare
(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fitimi/(humbja) para tatimit, shpërndarjeve tek zyra qendrore dhe rimatjes së mbetjes neto qe i takon zyres qendrore		729,843	(68,915)
Flukset monetare nga veprimtaria operuese			
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësim dhe amortizim	11,13	128,284	120,920
Zhvlerësim të aktivitet me të drejtë përdorimi	12	242,681	137,570
Të ardhura nga investimet	31	(377,080)	(391,159)
Shpenzimet financiare	31	105,024	86,970
Rënia në vlerë e të arketueshmeve nga sigurimi	18	50,365	507
Flukset monetare nga veprimtaria operuese para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operuese		879,117	(114,107)
Rritja/(ulja) në llogarite e arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera		189,837	(704,390)
Ulja e shpenzimeve të shtyra të marrjes në sigurim		242,160	54,095
(Rritja)/ulja në aktivet e tjera		(150,161)	128,393
(Ulja)/rritja në detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		(50,065)	376,807
Rritja/(ulja) në detyrimet për kontratat e sigurimit		1,025,231	(1,062,323)
Rritja në rezervën e primit të pafitur		474,118	351,295
(Rritja)/ulja në aktivet e risigurimit		(835,498)	1,298,410
Rritje në depozitën e risiguresit		432,118	10,786
Flukset monetare nga veprimtaria operuese para interesave dhe tatimit		2,206,857	338,966
Interesi i arkëtuar		425,607	356,640
Interesi i paguar		(40,977)	(45,986)
Tatim fitimi i paguar		(132,911)	-
Flukset monetare neto nga veprimtaria operuese		2,458,576	649,620
Flukset monetare nga veprimtaria investuese			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	11	(75,401)	(220,573)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	13	(54,409)	(249,194)
Te ardhurat nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale	11	39,724	6,591
Ulje në depozitat me afat	16	390,165	230,183
Investimet në letra me vlerë të mbajtuara me kosto të amortizuar	15	(2,248,750)	-
Flukset monetare te perdorura në veprimtarine investuese		(1,948,671)	(232,993)
Flukset monetare nga veprimtaria financuese			
Pagesa për qiradhënie	12	(279,490)	(160,846)
Shpërndarja tek zyra qendrore		(240,000)	-
Flukset monetare te perdorura në veprimtarine financuese		(519,490)	(160,846)
(Ulja)/rritja në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		(9,585)	255,781
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	20	928,589	672,808
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	20	919,004	928,589

Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë **Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare**

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

1. Informacione të përgjithshme

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nga Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group Sh.a. – Dega Kosovë (më poshtë refeluar "Dega") në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group SH.A. është person juridik i regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Kompania mëmë është Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe, Vjenë, Austri e cila zotëron 89.05% të aksioneve. Njësia kontrolluese përfundimtare e Grupit është Wiener Städtische Wechselseitiger Versicherungsverein - Vermögensverwaltung - Vienna Insurance Group, Vjenë, Austri.

Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group SH.A. operon në Kosovë përmes degës.

Dega është themeluar më 11 tetor 2004 dhe operon nën licencën e lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për të lëshuar sigurime të jo-jetës në Republikën e Kosovës duke ndjekur dispozitat e Ligjit Nr. 05 / L045 "Për Sigurimin". Dega gjithashtu kërkohet të depozitohet një shumë minimale prej 3,200 mijë Euro në formën e kapitalit themeltar në mënyrë që të jetë në gjendje të leshojë sigurimet për të cilat është licencuar në Republikën e Kosovës.

Me 31 dhjetor 2020, numri i personave të punësuar në Degë arrinte në 127 (2019: 127).

Veprimtaria kryesore: Veprimtaria kryesore e Degës përfshinë sigurimin e rrezikut për linjat e mëposhtme të biznesit:

- Detyrimet e palëve të treta për mjete motorrike;
- Sigurime prone;
- Rreziku në ndërtim (CAR);
- Shëndeti në udhëtim;
- Aksidente personale; dhe
- Sigurim i përgjithshëm i mjeteve motorrike

Adresa zyrtare e regjistruar: Zyrrat qendrore të Degës gjenden në adresën Aktash, Rr."Edmond Hoxha" nr.27, Prishtinë, Kosovë. Dega ka regjistruar 46 njësi si vende të tjera të biznesit në Kosovë.

Bordi Mbikqyrës dhe Bordi Drejtues gjatë vitit 2020 dhe deri në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare përbëhen si më poshtë:

Bordi Mikqyrës	Pozicioni
Mr. Peter Hoefinger	Kryetar
Mr. Christoph Rath	Zv. Kryetar
Mr. Jonard Prodani	Anëtar
Mr. Michael Hack	Anëtar
Ms. Sonja Raus	Anëtar

2. Mjedisi i funksionimit të Degës

Në mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli shpërthimin e COVID-19 si një pandemi globale. Në përgjigje të pandemisë, autoritetet Kosovare zbatuan masa të shumta duke u përpjekur të ndalojë përhapjen dhe ndikimin e COVID-19, të tilla si; ndalimet dhe kufizimet e udhëtimit, karantinat, urdhërat për qëndrim brenda shtëpive dhe kufizimet në aktivitetin e biznesit, përfshirë mbylljet. Këto masa, ndër të tjera, kanë kufizuar rëndë veprimtarinë ekonomike në Kosovë dhe kanë ndikuar negativisht, dhe mund të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në bizneset, pjesëmarrësit e tregut, klientët e Degës, si dhe ekonominë Kosovare dhe globale për një periudhë të panjohur kohore.

Drejtuesit po ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e operacioneve të Degës dhe për të mbështetur klientët dhe punonjësit e saj, ndër të tjera, përmes:

- monitorimit i likuiditetit në baza ditore;
- uljes së shpenzimeve administrative;
- rritja e arkëtimit; dhe
- investimi në teknologji informative, në mënyrë që të krijohet infrastruktura e përshtatshme për mjedisin e punës në distance.

Banka Qendrore e Kosovës si organ rregullator për institucionet financiare në Kosovë lëshoi një moratorium për Bankat gjatë vitit 2020. Sidoqoftë, i njëjti nuk ishte i zbatueshëm për Kompanitë e Sigurimeve. Pavarësisht nga sfidat dhe vështirësitë e imponuara nga Covid-19 gjatë vitit 2020, Dega ishte në gjendje të mbante operacionet e saj dhe vazhdoi të siguronte shërbime për klientët e saj pa ndërprerje të mëdha, të cilat nga ana tjetër ndihmuan në zbutjen e ndikimit të mundshëm të Covid-19 në performancën financiare. Dega ishte në gjendje të gjeneronte një rezultat operativ pozitiv, me fitimin e saj para tatimit për vitin që arrin në 730 mijë Euro (2019: 69 mijë Euro humbje). Të ardhurat neto janë rritur me 303 mijë Euro ose 4%. Rrjedha e parase nga veprimtaritë operative gjithashtu është përmirësuar dhe që me 31 dhjetor 2020 arrijnë në 2,459 mijë Euro (2019: 650 mijë Euro).

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

2. Mjedisi i funksionimit të Degës (vazhdim)

Për më tepër, aftësia paguese më 31 dhjetor 2020 bazuar në rritjen 150% është 2,013,638 Euro (2019: 2,013,638 Euro) ndërsa kapitali i disponueshëm është 1,728,355 Euro mbi minimumin e kërkuar (2019: 1,028,420 Euro mbi minimumin e kërkuar).

Sidoqoftë, situata pandemike ndikoi në proceset e përditshme të Degës pasi stafi u detyrua të punojë në distancë për një pjesë të caktuar të kohës dhe më pas në bazë rotacioni me një prani fizike në zyra. Për më tepër, proceset e nënshkrimit dhe trajtimit të dëmeve u përballën me një vonesë të përkohshme në tremujorin e dytë të vitit, duke qenë se qendrat e regjistrimit të policave të sigurimit të detyrueshëm dhe gjykatat për pretendimet e paleve nuk po funksiononin me kapacitetet e tyre të plota. Pavarësisht këtyre, Dega arriti të zbusë këto vonesa në semestrin e dytë të vitit.

Sidoqoftë, efektet e ardhshme të situatës aktuale ekonomike dhe masave të mësipërme janë vështirë të parashikueshme dhe pritjet dhe vlerësimet aktuale të Drejtuesve mund të ndryshojnë nga rezultatet aktuale.

3. Bazat e kontabilitetit

Deklarata e pajtueshmërisë. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) sipas konventës së kostos historike. Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur shprehet ndryshe (shiko shënimin 4 dhe 5 për miratimin e standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara dhe shpalljeve të reja kontabël të miratuara nga Dega). Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa çmuarjeve të rëndësishme kontabel. Gjithashtu kërkon që Drejtuesit të ushtrorjnë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Degës. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimin ose kompleksitetit, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare të janë shpalosur në Shënimin 9.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro ("Euro"), e cila është monedha funksionale e Degës dhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilin Dega kryen veprimtarinë e saj.

4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Amendimi i koncesioneve të qirave të lidhura me COVID-19 i SNRF 16 lëshuar më 28 maj 2020 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020. Amendimi u siguron qiramarrësve lehtësim në formën e një përjashtimi opsional nga gjykimi nëse një koncesion qiraje që lidhet me COVID-19 është një modifikim i qirasë. Qiradhënësit mund të zgjedhin të vlerësojnë koncesionet e qirasë në të njëjtën mënyrë sikur të mos ishin modifikime të qirasë. Përshtatshmëria praktike zbatohet vetëm për koncesionet e qirasë që ndodhin si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë COVID-19 dhe vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: ndryshimi në pagesat e qirasë rezulton në shqyrtimin e rishikuar të qirasë që është në thelb e njëjtë me, ose më pak se, shuma për qiranë që i paraprinë menjëherë ndryshimit; çdo ulje e pagesave të qirasë ndikon vetëm në pagesat e pagueshme më ose para 30 qershorit 2021; dhe nuk ka asnjë ndryshim thelbësor në termat dhe kushtet e tjera të qirasë.

Standardi i ndryshuar i cili u bë efektiv nga 1 qershori 2020, nuk pati një ndikim material në Degen.

Standardet e mëposhtme të ndryshuara u bënë efektive nga 1 Janari 2020, por nuk patën ndonjë ndikim material në Degen:

- Amendimet në Kornizën Konceptuale për Raportimin Financiar (lëshuar në 29 Mars 2018 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020).
- Përkufizimi i një biznesi - Ndryshimet në SNRF 3 (lëshuar më 22 tetor 2018 dhe efektive për blerjet nga fillimi i periudhës vjetore të raportimit që fillon në ose pas 1 janarit 2020).
- Përkufizimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (lëshuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2020).
- Reforma e nivelit të interesit - Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 (lëshuar më 26 shtator 2019 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2020).

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

5. Standardet e reja kontabël

Janë nxjerrë disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021 ose më vonë dhe të cilat Dega nuk ka miratuar në mënyrë të hershme.

Shitja ose dhurimi i aktiveve midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK). Këto ndryshime adresojnë një mospërputhje midis kërkesave të SNRF 10 dhe atyre në SNK 28 në trajtimin e shitjes ose të kontributit të aktiveve ndërmjet një investitori dhe shoqërisë së tij ose sipërmarrjes së përbashkët.

Pasjoja kryesore e ndryshimeve është se një fitim ose humbje e plotë njihet kur një transaksion përfshin një biznes. Një fitim ose humbje e pjesëshme njihet kur një transaksion përfshin aktivet që nuk përbëjnë një biznes, edhe nëse këto mjete mbahen nga një filial. Dega aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023). SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili i ka dhënë mundësi shoqërive që të mbajnë kontabilitetin për kontratat e sigurimit duke përdorur praktikat ekzistuese. Si pasojë, ishte e vështirë për investitorët të krahasojnë performancën financiare të shoqërive të ngjashme të sigurimit. SNRF 17 është një standard i vetëm i bazuar në parime për të llogaritur të gjitha llojet e kontratave të sigurimit, duke përfshirë kontratat e risigurimit që një sigures mban. Standardi kërkon njohjen dhe matjen e grupeve të kontratave të sigurimit në: (i) një vlerë aktuale të rregulluar nga rreziku i flukseve të ardhshme të parasë (flukset monetare të përmbushjes) që përfshijnë të gjithë informacionin në dispozicion për flukset e mjeteve monetare të përmbushjes në një mënyrë që është në përputhje me informacionin e tregut të vëzhgueshëm; plus (nëse kjo vlerë është një detyrim) ose minus (nëse kjo vlerë është një aktiv) (ii) një shumë që përfaqëson fitimin e pafituruar në grupin e kontratave (marzhi i shërbimit kontraktual). Siguresit do të njohin fitimin nga një grup i kontratave të sigurimit gjatë periudhës që ata ofrojnë mbulim sigurimi, dhe pasi ato lirohen nga rreziku. Nëse një grup i kontratave është ose bëhet humbje, një njësi ekonomike do të njohë menjëherë humbjen. Dega pret që të zbatohet standardin për garantimin e performancës që ai lëshon dhe aktualisht po vlerëson ndikimin e standardit të ri në pasqyrat financiare. Ndikimi i mundshëm në produktet e sigurimeve të vendosura në hua dhe instrumente të ngjashëm është gjithashtu në shqyrtim. Projekti SNRF 17 po organizohet dhe implementohet në Nivelin e Grupit. Dega është e përfshirë kryesisht në: Mësime të Aktuaristikës, Testim, Përgatitje të të dhënave të testimit. Trajnime të personelit në internet janë duke u kryer në baza mujore. Një studim paraprak i kërkesave teknike dhe thelbësore të SNRF 17 u krye para fillimit të projektit Groupwide SNRF 17. Pas analizimit të rezultateve të studimit paraprak, u krijua një strukturë e projektit në të gjithë Grupin. Standardi IFRS 17 është adresuar posaçërisht në një shumëllojshmëri të grupeve metodologjike të punës që nga fillimi i programit. Projekti i Grupit është gjithashtu duke u përqëndruar në rishikimin e modelit aktuarial dhe zbatimin e një nënshkruesi. Për shkak të kompleksitetit të projektit, aktualisht nuk është e mundur të përcaktohet plotësisht ndikimi në bilancin individual dhe zërat e pasqyrave të të ardhurave.

Ndryshimet në SNRF 17 dhe një ndryshim në SNRF 4 (lëshuar më 25 qershor 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023). Ndryshimet përfshijnë një numër sqarimesh të synuara për të lehtësuar zbatimin e SNRF 17, për të thjeshtuar disa kërkesa të standardit dhe tranzicionit. Ndryshimet kanë të bëjnë me tetë fusha të SNRF 17 dhe ato nuk synojnë të ndryshojnë parimet themelore të standardit. Ndryshimet e mëposhtme në SNRF 17 u bënë:

- **Data e hyrjes në fuqi:** Data efektive e SNRF 17 (duke përfshirë ndryshimet) është shtyrë për dy vjet në periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023; dhe data fikse e skadimit të përjashtimit të përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 në SNRF 4 gjithashtu është shtyrë për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023.
- **Rikuperimi i pritshëm i flukseve të parave të blerjes së sigurimeve:** Një njësi ekonomike kërkohet të alokojë një pjesë të kostove të blerjes në rinovimet e pritura të lidhura të kontratës dhe t'i njohë ato kosto si një aktiv derisa njësi ekonomike të njohë rinovimet e kontratës. Njësive ekonomike u kërkohet të vlerësojnë rikuperueshmërinë e aktivitetit në çdo datë raportimi, dhe të japin informacion specifik në lidhje me aktivin në shënimet e pasqyrave financiare.
- **Marzhi i shërbimit kontraktual që i atribuohet shërbimeve të investimit:** Njësitë e mbulimit duhet të identifikohen, duke marrë parasysh sasinë e përfitimeve dhe periudhën e pritshme të mbulimit të sigurimeve dhe shërbimeve të investimeve, për kontratat nën qasjen e tarifës së ndryshueshme dhe për kontratat e tjera me një "shërbim kthimi investimi" modeli i përgjithshëm. Kostot në lidhje me aktivitetet e investimeve duhet të përfshihen si flukse parash në kufirin e një kontrate sigurimi, në masën që njësi ekonomike kryen aktivitetet të tilla për të rritur përfitimet nga mbulimi i sigurimit për mbajtësin e policës.

5. Standardet e reja kontabel (vazhdim)

- *Kontratat e risigurimit të mbajtura - rikuperimi i humbjeve:* Kur një njësi ekonomike njih një humbje me njohjen fillestare të një grupi të vështirë të kontratave themelore të sigurimit, ose me shtimin e kontratave themelore të një grupi, një njësi ekonomike duhet të rregullojë marzhin e shërbimit kontraktual të një grupi të lidhur të kontratave të risigurimit të mbajtura dhe njohin një fitim të kontratave të risigurimit të mbajtura. Shuma e humbjes së rikuperuar nga një kontratë risigurimi e mbajtur përcaktohet duke shumëzuar humbjen e njohur në kontratat themelore të sigurimit dhe përqindjen e pretendimeve mbi kontratat themelore të sigurimit që njësi ekonomike pret të rimarrë nga kontrata e risigurimit të mbajtur. Kjo kërkesë do të zbatohet vetëm kur kontrata e risigurimit të mbajtur njihet para ose në të njëjtën kohë kur humbja njihet në kontratat themelore të sigurimit.
- *Ndryshime të tjera:* Ndryshime të tjera përfshijnë përjashtime të fushës për disa kontrata të kartave të kreditit (ose të ngjashme), dhe disa kontrata kredie; paraqitja e aktiveve dhe detyrimeve të kontratës së sigurimit në pasqyrën e pozicionit financiar në portofolet në vend të grupeve; zbatueshmëria e opsionit të lehtësimit të rrezikut kur lehtësohen rreziqet financiare duke përdorur kontratat e risigurimit të mbajtura dhe instrumentet financiare jo derivativ me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes; një zgjedhje e politikës kontabel për të ndryshuar vlerësimet e bëra në pasqyrat e mëparshme financiare të ndërmjetme kur zbatohet SNRF 17; përfshirja e pagesave dhe faturave të tatimit mbi të ardhurat që i ngarkohen posaçërisht mbajtësit të policës nën kushtet e një kontrate të sigurimit në përmbushjen e flukseve të parasë; dhe lehtësimet e zgjedhura të tranzicionit dhe ndryshime të tjera të vogla.

Standarde dhe interpretime të tjera të reja janë leshuar, të cilat janë detyruesisht të aplikueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021 ose më vonë, dhe të cilat Dega nuk i ka miratuar me heret. Keto standarde përfshijnë:

- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata - Ndryshime në SNK 1 (lëshuar më 23 janar 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata, shtyrja e datës efektive - Ndryshimet në SNK 1 (lëshuar më 15 korrik 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- Të ardhurat para përdorimit të synuar, Kontratat e vështira - kostoja e përmbushjes së një kontrate, Referenca në Kuadrin Konceptual - ndryshime me fushëveprim të ngushtë në SNK 16, SNK 37 dhe SNRF 3, dhe Përmirësimet Vjetore të SNRF-ve 2018-2020 - ndryshime në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41 (lëshuar në 14 maj 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- Reforma e normës së interesit (IBOR) - ndryshimet në fazën 2 të SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 (lëshuar më 27 gusht 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).

Dega aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare. Përveç nëse përshkruhet ndryshe më sipër, standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në pasqyrat financiare të Deges.

6. Politika të rëndësishme kontabel

Politikat kontabel të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme nga Dega, përveçse rastet kur është shprehur ndryshe.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë transaksione të ndërmarra nga Dega në monedha të ndryshme nga ajo funksionale. Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj përkthehen në Euro me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë njohur me kosto historike konvertohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

(b) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Produktet e sigurimit të Degës klasifikohen në momentin e krijimit, për arsye kontabel, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi mbetet e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose pushojnë së ekzistuari. Kontratat nën të cilat Dega pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfituesin tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja sigurorese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesin e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të ardhshme të mundshme në një ose më shumë norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese, indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiare kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

6. Politika të rëndësishme kontabel (vazhdim)

Kontratat e përgjithshme të sigurimit. Detyrimet e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të vecantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e angazhimeve të ardhshme (të pafituara), rreziku i angazhimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e angazhimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (provizionet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Dega nuk i skanton detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet me pasiguritë dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara. Dega ka përdorur kërkesat e rregullatorëve ose mbikëqyrësve të sigurimit për të vendosur detyrimet e duhura të sigurimit.

Prime të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit. Primet e shkruara bruto përbëjnë shumat e detyruara gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma mund ti perkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhe kontabel të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe nuk përfshijnë tatimet dhe detyrime doganore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëshmipërblymit, në bazë të rrezikut të nënshkruar.

Rezerva për primin e pafituar. Rezerva e primit të pafituar në të gjitha segmentet e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila vlerësohet të fitohet në vitin financiar pasardhës, duke përdorur metodën ditore në bazë proporcionale 1/365, e rregulluar nëse nevojitet në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Primi i pafituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e nënshkruara të cilat prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatimet dhe detyrimet doganore të bazuara tek primet. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim njihen më vete si aktive.

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në pozicionin e tij financiar dhe flukset e parave. Kohëzgjatja e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon për këtë në çfarë mase është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Normat e interesit të marra dhe / ose të paguara nga Dega në një instrument financiar janë fikse. Profili i normës së interesit të instrumenteve financiare me interes të Degës siç raportohet më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë.

	Shenimi	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Instrumente me norme fikse			
<i>Aktive financiare me norme interesi fikse</i>			
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	15	6,528,388	4,297,031
Depozita me afat me banka	16	9,175,647	9,596,947
<i>Detyrime financiare me norme interesi fikse</i>			
Depozita e risiguruesit	24	(2,883,086)	(2,450,968)
Detyrimet për qira	12	(2,075,036)	(1,046,168)
Gjithsej		10,745,913	10,396,842

Një ndryshim prej 100 pikësh bazë në normat e interesit do të kishte rritur ose ulur kapitalin me 107,459 Euro (2019: 103,968 mijë Euro). Kjo analizë supozon se të gjitha variablat e tjerë, veçanërisht kurset e këmbimit të valutave të huaja, mbeten konstante.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë i referohet rrezikut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për Degën. Përgjatë kursit normal të biznesit, tekta arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Dega ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë përmes aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuar, depozitave me afat me banka, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe të arkëtueshmeve të risigurimit. Dega ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BBB- ose më të larta sipas S&P, Moody apo AM Best dhe të plotësojnë kërkesat e VIG përsa i përket Rregullave të Sigurisë për Risigurimet. Dega menaxhon ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuar dhe depozitave me afat me banka.

Ekspozimi maksimal i degës ndaj rrezikut të kredisë sipas klasës së aktiveve është pasqyruar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë. Cilësia e aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe të sigurimit shpaloset në shënimet përkatëse:

	Shënimi	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktive të risigurimit	14	5,450,289	4,614,791
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	15	6,528,388	4,297,031
Depozita me afat me banka	16	9,175,647	9,596,947
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	18	1,194,796	1,434,998
Aktive të tjera	19	390,346	240,185
Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to	20	919,004	928,589
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kreditit		23,658,470	21,112,541

Asnjë indikacion objektiv për rënie në vlerë nuk është identifikuar nga Dega në aktivet e tjera financiare në datën e raportimit. Aktivet e tjera financiare siç janë ekuivalentët e parave dhe depozitat me afat nuk janë as të vonuara dhe as të zhvlerësuara.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

8. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Dega nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Rreziku i likuiditetit është një rrezik i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Degës sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Dega do të kërkonte shumën të konsiderueshme brenda një periudhe të shkurtër duke tejkaluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Pavarësisht kësaj, Dega ka akses në huamarrje më 31 dhjetor 2020 dhe 2019. Dega menaxhon rrezikun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përpunuar maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare të Degës më 31 dhjetor 2020 të detajuara sipas maturitetit paraqiten më poshtë:

	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Midis 1 vit dhe 5 vjet	Gjithsej
Aktivitet				
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	919,004	-	-	919,004
Depozita me afat me banka	1,709,566	4,147,895	3,318,186	9,175,647
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	1,023,016	83,750	88,030	1,194,796
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuara	54,218	141,981	6,332,189	6,528,388
Aktive të risigurimit	368,292	1,611,553	3,470,444	5,450,289
Aktive të tjera	92,703	7,555	-	104,258
Gjithset aktivet financiare	4,166,799	5,992,734	13,208,849	23,372,382
Detyrimet				
Detyrime për kontratat e sigurimit	739,732	1,468,481	7,963,977	10,172,190
Rezerva e primit të pafitur	227,422	4,211,313	112,126	4,550,861
Depozita e risiguresit	319,250	319,250	2,244,586	2,883,086
Detyrimet për qira	71,109	213,326	2,058,371	2,342,806
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	891,524	149,702	85,312	1,126,538
Gjithsej detyrimet financiare	2,249,037	6,362,072	12,464,372	21,075,481
Pozicioni i likuiditetit neto	1,917,762	(365,338)	744,477	2,296,901

Aktivitetet dhe detyrimet financiare të Degës më 31 dhjetor 2019 të detajuara sipas maturitetit paraqiten më poshtë:

	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Midis 1 vit dhe 5 vjet	Gjithsej
Aktivitet				
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	928,589	-	-	928,589
Depozita me afat me banka	426,947	4,870,000	4,300,000	9,596,947
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	1,404,516	28,473	2,009	1,434,998
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuara	75,923	2,406,579	1,814,529	4,297,031
Aktive të risigurimit	3,708,837	854,976	50,978	4,614,791
Aktive të tjera	107,105	8,080	-	115,185
Gjithset aktivet financiare	6,651,917	8,116,810	6,167,516	20,987,541
Detyrimet				
Detyrime për kontratat e sigurimit	3,988,253	3,358,673	1,800,033	9,146,959
Rezerva e primit të pafitur	198,702	3,659,824	218,217	4,076,743
Depozita e risiguresit	1,870,675	-	580,293	2,450,968
Detyrimet për qira	34,962	104,886	1,063,313	1,203,161
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	1,146,984	29,619	-	1,176,603
Gjithsej detyrimet financiare	7,239,576	7,153,002	3,661,856	18,054,434
Pozicioni i likuiditetit neto	(587,659)	1,015,106	2,505,660	2,933,107

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

8. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Në pozicionin e likuiditetit të Degës, të paraqitur më lart për vitet 2020 dhe 2019, flukset e paskontuara hyrëse dhe dalëse janë shpalosur përkatësisht. Sa i përket detyrimeve për kontratat e sigurimit, flukset dalëse të pa skontuara janë paraqitur duke supozuar se periudha maksimale e detyrueshme e shlyerjes, sipas legjislacionit në fuqi, do të respektohet. Sidoqoftë, situatat mund të ndodhin kur Dega dhe paditësi nuk ndajnë të njëjtat pikëpamje në lidhje me vlerësimin e kërkesës, prandaj ata mund të përfundojnë në zgjidhjen e çështjes në një proces gjyqësor, i cili kërkon një periudhë më të gjatë kohore për tu zgjidhur në krahasim me atë që parashikohej fillimisht.

Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Dega nuk ka kapital sipas legjislacionit vendor. Sidoqoftë, Banka Qendrore e Kosovës kërkon që degët e subjekteve të huaja të depozitojnë një shumë të caktuar si kapital themeltar. Kështu, Dega paraqet shumën si kapital themeltar në pasqyrën e saj të pozicionit financiar. Dega menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që nivelet e mjaftueshme të kapitalit të mbahen për Degën për të qenë në gjendje të bëjë të mundur vijimësinë e aktivitetit dhe dhe të jenë në përputhje me kërkesat e kapitalit të rregullatorëve, duke maksimizuar kthimin tek palët e interesit përmes një optimizimi të bilancit të borxhit me kapitalin.

Më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019, Dega ka përmblusur të gjitha kërkesat e kapitalit, duke përfshirë marzhin e aftësisë paguese dhe raportin e aktiveve që mbulojnë detyrimet nga kontratat e sigurimit.

Dega duhet të jete në përputhje me legjislacionin vendor, përfshirë rregullat dhe rregulloret e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës. Sipas Rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës " Mbi depozitimin e asetëve si garancë, mjaftueshmërisë së kapitalit, raportimin financiar, menaxhimin e rrezikut, investimeve dhe likuiditetin", neni 7, të gjitha kompanive të sigurimeve u kërkohet një kapital total prej 3,200 mijë Euro.

	Shënime	2020	2019
Gjithsej mbetjet neto që i takojnë zyrës qendrore	21	5,997,878	5,611,923
Marzhi i aftësisë paguese (solvencës) me bazë primi		1,326,800	1,342,425
Marzhi i aftësisë paguese (solvencës) me bazë të dëmeve		954,489	963,223
Aftësia paguese mbi bazën e rritjes prej 150%(1)		2,013,638	2,013,638
Fondi garantues sipas ligjit (2)		3,200,000	3,200,000
Kërkesa për kapital sipas Fondit Garantues (vlera më e madhe mes 1 & 2)		3,200,000	3,200,000
Niveli aktual i aftësisë paguese për Degën		4,928,355	4,228,420
Në % të kapitalit të kërkuar		154%	132%

Rreziqe të tjera

Ndryshimet në rregulloret qeveritare për segmentet e tregut në të cilat Dega operon mund të prekin përfitueshmërinë e saj. Tregu i sigurimeve është subjekt i mbikeqyrjeve gjithëpërfshirëse dhe dinamike. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e policëmbajtësve. Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret aktuale të sigurimit mund të ndikojnë mënyrën me të cilën Dega drejton aktivitetin e biznesit dhe produktet që ofron. Për më tepër, përshtatja dhe amendimi i herë pas hershëm i ligjeve të sigurimit ose rregulloreve mund t'i bëjë ato më kufizuese ose të rezultojnë në kosto më të larta sesa kërkesat në aktuale.

9. Vlerësimet dhe gjykimet në zbatimin e politikave kontabël

Dega bën gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Drejtuesit gjithashtu bëjnë gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël.

Pretendimet dhe përfitimet e policëmbajtësit

Vlerësimi i detyrimit përfundimtar që rrjedh nga demet e ndodhura sipas kontratave të sigurimit është vlerësimi më kritik kontabël i Degës. Vendimet e Degës për humbjet e raportuara dhe të paraportuara dhe vendosja e rezervave rezultuese dhe risigurimit të lidhur me të, rishikohen dhe përditësohen çdo vit dhe rregullimet që rrjedhin nga ky rishikim pasqyrohen në fitim ose humbje. Proçesi bazohet në supozimin se përvoja e kaluar, e përshtatur për efektin e zhvillimeve aktuale dhe tendencave të mundshme, është një bazë e përshtatshme për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit diskutohet në detaje në Shënimin 7, ndërsa dispozitat e kontratës së sigurimit analizohen në Shënimin 22.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

9. Vlerësimet dhe gjykimet në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)

Të arkëtueshmet nga sigurimet dhe humbjet nga rënia në vlerë

Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera fillimisht njihen me vlerën e drejtë. Më pas të arkëtueshmet maten me koston e amortizuar minus humbjet nga rënia në vlerë. Vlerësimi i lejimit për humbjet nga rënia në vlerë është gjithashtu një vlerësim i kryer nga Drejtuesit. Të arkëtueshmet e sigurimeve vlerësohen për rënie në vlerë në çdo datë raportimi. Të arkëtueshmet e sigurimeve me më shumë se një vit zhvlerësohen plotësisht nëse nuk ka probabilitet të lartë që ato të mbliidhen. Një probabilitet i tillë ekziston kur Dega ka marrëdhënie afatgjatë me klientë të rëndësishëm ose kur Dega blen mallra dhe / ose shërbime nga i siguruari dhe llogaritë e arkëtueshme shlyhen në baza neto. Të arkëtueshmet e sigurimeve me më pak se një vit vlerësohen individualisht në rast se ka tregues se ato nuk do të arketohen dot.

Të arkëtueshmet e sigurimeve me më pak se një vit vlerësohen gjithashtu në baza kolektive të grupuara në bazë të karakteristikave të rrezikut të kredisë, zakonisht me datën e raportimit. Përqindjet e zhvlerësimeve të aplikuara për secilën kategori të llogarive të arkëtueshme të sigurimeve me më pak se një vit, përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të Drejtuesve për humbjet e pritshme në të ardhmen dhe bazohen në historinë e rikuperueshmërisë dhe përvojën e tregut.

10. Vlera e drejtë

Matjet e vlerës së drejtë për qëllime matjeje dhe / ose prezantimi analizohen sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë, që vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha informacionet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose detyrimin, ose drejtpërdrejt (dmth. si çmime) ose indirekt (të derivuara nga çmimet); dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen në të dhënat e vëzhgueshme të tregut që është, (inputet e pavezgueshme). Drejtuesit aplikojnë gjykimin për kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse një matje e vlerës së drejtë përdor informacione të vëzhgueshme që kërkojnë një rregullim të rëndësishëm, kjo matje është një matje e Nivelit 3. Rëndësia e një informacioni vlerësohet në matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e saj.

Dega nuk ka aktive të cilat maten me vlerën e drejte në datën e raportimit.

Aktivitet dhe detyrimet që nuk maten me vlerën e drejtë, por për të cilat vlera e drejtë është shpalosur

Vlera e drejtë e analizuar sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë dhe vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve që nuk maten me vlerën e drejtë janë si më poshtë. Të arkëtueshmet e sigurimeve nuk përfshihen pasi për ato nuk kërkohet vlera e drejtë.

	Vlera kontabel	Niveli 1	Vlera e drejtë	
			Niveli 2	Niveli 3
31 dhjetor 2020				
Depozita me afat me banka	9,175,647	-	9,178,829	-
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	6,528,388	-	6,882,614	-
Aktivitet e risigurimit	5,450,289	-	5,450,289	-
Aktive të tjera financiare	100,258	-	100,258	-
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	1,194,796	-	1,194,796	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	919,004	919,004	-	-
31 dhjetor 2019				
Depozita me afat me banka	9,596,947	-	9,600,275	-
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	4,297,031	-	4,802,715	-
Aktivitet e risigurimit	4,614,791	-	4,614,791	-
Aktive të tjera financiare	115,185	-	115,185	-
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	1,434,998	-	1,434,998	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	928,589	928,589	-	-

Aktivitet financiare të mbajtura me koston e amortizuar. Vlera e drejtë e vlerësuar e instrumentave me norme fikse të interesit bazohet në flukset monetare të ardhshme, që pritet të arkëtohen, të skontuara me normat aktuale të interesit për instrumente të reja me rreze të ngjashme kreditore dhe maturime të mbetura të ngjashme. Vlera e drejtë e aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuar është përcaktuar në bazë të çmimeve të kuotuar të shpallura nga Banka Qendrore e Kosovës për të njëjtin instrument duke marrë në konsideratë maturim të ngjashëm me maturimin e instrumenteve të mbajtura nga Dega. Detyrimet financiare të Degës janë afatshkurtra dhe vlerat e tyre kontabel zakonisht janë të barabarta me vlerat e tyre të drejta.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

11. Aktive afatgjata materiale

Lëvizjet gjatë 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	Mobilje dhe pajisje zyre	Përmiresime të ambjentëve të marra me qera	Vetura	Pajisje kompjuterike	Gjithsej
Kosto					
Në 1 janar 2019	489,012	17,151	299,253	164,662	970,078
Shtesa	35,645	52,496	57,966	74,466	220,573
Pakësime	-	-	(94,202)	-	(94,202)
Në 31 dhjetor 2019	524,657	69,647	263,017	239,128	1,096,449
Shtesa	27,153	18,632	-	29,616	75,401
Pakësime	(1,466)	-	-	(6,645)	(8,111)
Në 31 dhjetor 2020	550,344	88,279	263,017	262,099	1,163,739
Zhvlerësimi i akumuluar					
Në 1 janar 2019	(406,230)	(3,158)	(167,157)	(103,435)	(679,980)
Shpenzimi i vitit	(30,626)	(13,993)	(35,543)	(18,392)	(98,554)
Pakësime	-	-	87,612	-	87,612
Në 31 dhjetor 2019	(436,856)	(17,151)	(115,088)	(121,827)	(690,922)
Shpenzimi i vitit	(23,308)	(7,113)	(29,585)	(26,916)	(86,922)
Pakësime	963	-	-	5,805	6,768
Në 31 dhjetor 2020	(459,201)	(24,264)	(144,673)	(142,938)	(771,076)
Vlera e mbartur					-
Në 31 dhjetor 2019	87,801	52,496	147,929	117,301	405,527
Në 31 dhjetor 2020	91,143	64,015	118,344	119,161	392,663

12. Aktivet me të drejte perdorimi dhe detyrimet për qira

	Ndertesat
Kosto	
Në 1 janar 2019	1,155,811
Shtesa	215,544
Pakësime	(205,325)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(137,570)
Në 31 dhjetor 2019	1,028,460
Shtesa	1,259,498
Pakësime	(15,596)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(242,681)
Në 31 dhjetor 2020	2,029,681

Shpenzimet në lidhje me pagesat e qirave afatshkurtër që nuk përfshihen në detyrimet e qirasë të përfshira në shpenzimet administrative të vitit 2020 ishin 15,360 Euro (2019: 79,291 Euro).

	2020	2019
Shpenzimet për qirate afatshkurtra	15,360	79,291
Gjithsej	15,360	79,291

Pagesat për qira në vitin 2020 ishin 279,490 Euro (2019: 160,846 Euro). Marrëveshjet e qirasë nuk imponojnë ndonjë kushtezim përveç interesit në aktivet me qira që mbahen nga qiradhënësi. Aktivet me qira nuk mund të përdoren si kolateral për huazimet. Opsionet e zgjatjes dhe ndërprerjes së marrëveshjes janë përfshirë në të gjitha marrëveshjet e qirasë të nënshkruara nga Dega. Këto përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në drejtim të menaxhimit të pasurive të përdorura në operacionet e Degës

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

12. Aktivet me të drejte perdorimi dhe detyrimet për qira (vazhdim)

Tabela më poshtë shpalos një analizë të detyrimeve nga aktivitetet e financimit dhe lëvizjeve në detyrimet e Degës nga aktivitetet e financimit për secilën nga periudhat e paraqitura. Perberesit e këtyre detyrimeve janë ato që raportohen si aktivitete financuese në pasqyrën e rrjedhës së parasë:

	Detyrimet për qira	Gjithsej
Detyrimet nga aktivitetet e financimit 31 dhjetor 2018	-	-
Zbatimi i standartit të ri	1,155,811	1,155,811
Detyrimet nga aktivitetet e financimit 1 janar 2019	1,155,811	1,155,811
Flukset dalese gjate vitit	(160,846)	(160,846)
Marrëveshtet e përfunduara të qirasë	(207,769)	(207,769)
Marrëveshjet e reja të qirasë	215,544	215,544
Interesi i përlogaritur	43,428	43,428
Detyrimet nga aktivitetet e financimit 31 dhjetor 2019	1,046,168	1,046,168
Flukset dalëse e parasë gjatë vitit	(279,490)	(279,490)
Marrëveshjet e përfunduara të qirasë	(15,595)	(15,595)
Marrëveshjet e reja të qirasë	1,259,498	1,259,498
Interesi i përlogaritur	64,455	64,455
Detyrimet nga aktivitetet e financimit 31 dhjetor 2020	2,075,036	2,075,036

13. Aktivet afatgjata jomateriale

	Programe kompjuterike
Kosto	
Në 1 janar 2019	140,396
Shtesa	249,194
Në 31 dhjetor 2019	389,590
Shtesa	54,409
Pakësime	(41,887)
Në 31 dhjetor 2020	402,112
Amortizimi i akumuluar	
Në 1 janar 2019	(59,518)
Shpenzimi i vitit	(22,366)
Në 31 dhjetor 2019	(81,884)
Shpenzimi i vitit	(41,362)
Pakësime	3,505
Në 31 dhjetor 2020	(119,741)
Vlera e mbartur	
Në 31 dhjetor 2019	307,706
Në 31 dhjetor 2020	282,371

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

14. Aktive të risigurimit

Pjesa e risiguresit në detyrimet e sigurimit është si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<i>Pjesa e risiguresit në primin e pafituar</i>		
Pronë	532,287	562,855
Shendeti dhe aksidente	91	564
Të tjera	450,128	388,953
	982,506	952,372
<i>Pjesa e risiguresit në dëmet e raportuara</i>		
Mjete motorrike	3,205,740	2,743,344
Pronë	1,094,977	826,610
Shendeti dhe aksidente	149,101	84,488
Të tjera	17,965	7,977
	4,467,783	3,662,419
Gjithsej	5,450,289	4,614,791

Aktivet e risigurimit të Degës nuk janë të siguruara dhe as në vonesë apo të provizionuara. Aktivet monitorohen sipas vlerësimit të kredisë.

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 rreziku i kredisë të primeve të ceduara të risigurimit sipas vlerësimit është si më poshtë:

	31 dhjetor 2020				31 dhjetor 2019			
	Prime të ceduara 'në Euro	% e totalit	Aktive të risigurimit 'në Euro	% e totalit	Prime të ceduara 'në Euro	% e totalit	Aktive të risigurimit 'në Euro	% e totalit
Vlerësimi								
A+	4,630,561	82.47%	4,622,890	84.82%	3,962,302	83.34%	3,794,057	82.22%
A	209,161	3.73%	86,077	1.58%	193,664	4.07%	71,881	1.56%
AA	227,740	4.06%	87,386	1.60%	232,464	4.89%	65,625	1.42%
AA-	514,287	9.16%	113,845	2.09%	251,072	5.28%	72,024	1.56%
A-	14,640	0.26%	5,886	0.11%	65,900	1.39%	18,019	0.39%
Pa vlerësuar	18,228	0.32%	534,205	9.80%	48,716	1.02%	593,185	12.85%
Gjithsej	5,614,617	100.00%	5,450,289	100.00%	4,754,118	100.00%	4,614,791	100.00%

Shuma prej 534 mijë Euro (2019: 593 mijë Euro), përfaqëson aktivet e risigurimit, që janë të arkëtueshme nga risiguresit që nuk janë vlerësuar nga agjencitë vlerësuese.

15. Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Vlera nominale	6,510,000	4,260,000
Primi i paamortizuar	(37,879)	(38,892)
Interesi i akumuluar	56,267	75,923
Gjithsej	6,528,388	4,297,031

Investimet në letra me vlerë përfshijnë obligacione qeveritare të Republikës së Kosovës, të cilat kanë vlerën e 6,528,338 Euro (2019:4,297,031 Euro). Bonot qeveritare janë blerë duke përdorur tregun primar dhe tregun sekondar përmes Raiffeisen Bank në Kosovë dhe Banka Kombetare Tregtare dhe maturimi është nga tre deri në dhjetë vjet.

Megjithëse obligacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk janë vlerësuar, borxhi publik aktualisht është në nivele nën 20% të PBB-së dhe duke përfshirë rritjen e parashikuar të tij në planin afatmesëm pritet të mbetet nën 30% të PBB-së, tavan i cili konsiderohet konservativ për një vend si Kosova. Niveli i tillë i borxhit publik së bashku me stabilitetin e përgjithshëm buxhetor që kërkon çdo deficit buxhetor të mbetet brenda 2% të PBB-së pas rregullit fiskal të FMN-së, janë faktorët kryesorë në vlerësimin e instrumenteve të Qeverisë së Kosovës si të qëndrueshme.

Si Raiffeisen Bank Kosova ashtu edhe Banka Kombetare Tregtare përmes të cilave blihen obligacionet kanë një vlerësim të qëndrueshëm kreditor, me të parën që vlerësohen si A- nga S&P ndërsa e dyta BB- nga Fitch.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

16. Depozita me afat me banka

Ndarja e depozitave me afat maturimi mbi tre muaj, por më pak se një vit nga banka është si më poshtë:

Depozita me afat	Agjensia	Vlerësimi	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Banka Kombëtare Tregtare	Fitch	BB-	3,150,000	3,000,000
NLB Kosova	Moody's	BAA2	2,400,000	2,400,000
Turkiye Is Bankasi	Fitch	BB+	1,600,000	1,600,000
Banka për Biznes Kosovë	n/a	-	1,450,000	1,450,000
Banka Qendrore e Kosovës	n/a	-	320,156	320,321
TEB Bank Kosovë	Fitch	B+	180,000	720,000
Interesi i akumuluar	n/a	n/a	75,491	106,626
Gjithsej depozita bankare			9,175,647	9,596,947

Institucionet financiare të pavlerësuara përfshijnë Bankën Qendrore të Kosovës që është organi rregullator për institucionet financiare në Republikën e Kosovës dhe Banka për Biznes që është një bankë lokale. Kjo e fundit është një bankë e qëndrueshme lokale, që operon në tregun lokal, ka aksionarë vendas dhe është e vendosur mirë në treg. Të gjitha bilancet me bankat e mësipërme nuk janë as të vonuara as të rena në vlerë.

Mjetet monetare dhe depozitat e Degës janë vendosur pranë institucioneve financiare si më poshtë:

	Agjensia	Vlerësimi	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
			Depozita dhe llogari rrjedhëse	Nga të cilat llogari rrjedhëse (shënimi 20)	Depozita dhe llogari rrjedhëse	Nga të cilat llogari rrjedhëse (shënimi 20)
ProCredit Bank	Fitch	BBB	13,405	13,405	97,605	97,605
Raiffeisen Bank	Moody's	A3	63,118	63,118	1,819	1,819
Banka Kombetare Tregtare	Fitch	BB-	3,894,722	719,975	3,624,552	605,796
Banka për Biznes	n/a	-	1,489,805	16,293	1,492,888	11,357
TEB	Fitch	B+	212,299	30,950	924,849	192,562
Central Bank of Kosovo	n/a	-	320,156	-	320,322	-
Banka Ekonomike	n/a	-	42	42	78	78
NLB Kosovo	Moody's	BAA2	2,433,360	21,565	2,423,467	11,684
IS Bank	Fitch	BB+	1,667,744	53,656	1,639,956	7,688
Gjithsej mjete monetare dhe depozita bankare			10,094,651	919,004	10,525,536	928,589

Depozitat me afat mbahen me institucionet financiare vendore. Norma e interesit për depozitat me afat gjatë vitit 2020 ishte në intervalet ndërmjet 1.5% deri 2.91% në vit (2019: 1.2% në 2.91% në vit). Në bazë të Rregullës 8 të miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës është përcaktuar një shumë minimale kolaterale prej të paktën 10% të kapitalit ose 3,200 mijë Euro të mbahet me llogarinë e BQK-së nderkaq pjesa e mbetur me bankat e tjera tregtare, por jo më shumë se 30% në një bankë të vetme.

17. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim përfshijnë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Komisione të agjentëve	206,989	303,568
Pagat e departamentit të marrjes në sigurim dhe shitjes	148,758	171,262
Tatimi mbi primin	-	132,726
Shpenzimi tatimore për mbikëqyrje	72,031	62,382
Gjithsej	427,778	669,938

Lëvizjet në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë si më poshte:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Gjendja më 1 janar	669,938	724,033
Rritje në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	624,105	894,359
Shpenzimet e marrjes në sigurim	(866,265)	(948,454)
Më 31 dhjetor	427,778	669,938

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. Dega Kosovë
Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

18. Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera

Të arkëtueshmet nga sigurimet e agjentëve dhe klientëve perbehen nga:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të arkëtueshme nga policëmbajtësit	1,063,508	1,278,118
Të arkëtueshme nga kompanitë e sigurimit	117,166	107,106
Të arkëtueshme nga agjentët	109,165	94,452
Provizioni për të arkëtueshmet e dyshimta të sigurimit	(95,043)	(44,678)
Gjithsej	1,194,796	1,434,998

Lëvizjet në lejimin për humbjet nga rënia në vlerë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Gjendja më 1 janar	44,678	44,171
Shpenzimi i vitit	50,365	507
Fshirje e borxhit të keq	-	-
